



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1472/13 prot.

Datë 25.06.2026

V E N D I M

Nr. 870/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.795/2026, datë 12.06.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, Shërbime, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-81685-04-10-2026, me objekt “*Sherbime topografie për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara*”, me fond limit 3,994,020 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëzetë) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “GEO SUD” SHPK, me NIPT L57128218D, me adresa: Rruga Sulejman Delvina, Lagjja Hajro Çakeri, Objekt Nr.21, Kati I. Vlorë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara sh.a
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 12.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.795/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “GEO SUD” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, Shërbime, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-81685-04-10-2026, me objekt “Sherbime topografie për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara” për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, me fond limit 3,994,020 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëzetë) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe të dërgojë hard-copy e DTS së re, përpara publikimit.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “GEO SUD” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1.2. Me shkresën nr. 1757/13 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1472/10 prot., datë 25.06.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 795/2026, datë 12.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, Shërbime, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-81685-04-10-2026, me objekt “Sherbime topografie për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara” për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, me fond limit 3,994,020 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëzetë) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara sh.a.

-bashkëlidhur ka dërguar edhe dokumentin “Formular Njoftim Anulimi” me nr. 1757/1 prot., datë 15.06.2026;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 1757/13 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1472/10 prot., datë 25.06.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 795/2026, datë 12.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, Shërbime, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-81685-04-10-2026, me objekt “Shërbime topografie për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara” për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, me fond limit 3,994,020 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëzetë) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara sh.a.
-bashkëlidhur ka dërguar edhe dokumentin “Formular Njoftim Anulimi” me nr. 1757/1 prot., datë 15.06.2026;

II.2. Nga verifikimi i procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit të sipërcituar, në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.795/2026, datë 12.06.2026. Gjithashtu, bashkëlidhur informacionit, ka dërguar edhe dokumentin “Formular Njoftim Anulimi” me nr. 1757/1 prot., datë 15.06.2026, si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 40, datë 22.06.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar, Shërbime, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-81685-04-10-2026, me objekt “Shërbime topografie për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara” për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, me fond limit 3,994,020 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëzetë) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 27.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtare
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

